




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPKI
 Dep. 02
 Dep. 02
 Nr. i faq. 02
 Nr. Prot. 06-02/4045/22
 Br. Prot. 06-02/4045/22
 Prot. No. 06-02/4045/22
 Data 06.10.2022
 Datum 06.10.2022



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
 AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
 AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 04.10.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-2598/21, për zyrtarin e lartë z. Gramos Agusholli, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Gramos Agusholli, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi është identifikuar se z. Gramos Agusholli, krahas ushtrimit të funksionit publik Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është edhe përfaqësues i autorizuar në tre biznese private: "Global Center" SH.P.K., "Laboratori Art Dental" SH.P.K. dhe "Global Tire Center" SH.P.K.

Fillimisht, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me qëllim të verifikimit të gjendjes së papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, ka kërkuar informatat për bizneset në fjalë nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK). Nga informatat për bizneset të cilat Agjencia i ka pranuar prej ARBK-së (shkresa zyrtare: DPKI-06-2598/21), është konstatuar se zyrtari i lartë z. Gramos Agusholli, figuron si person i autorizuar në bizneset e sipërshënuara.

Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-06-02/2169/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, z. Gramos Agusholli është njoftuar lidhur me faktet për rastin e tij, si dhe është udhëzuar për veprimet që



duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë përfaqësues i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.

Zyrtari i lartë z. Gramos Agusholli, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka deklaruar se se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e papajtueshmërisë - konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar informatën të cilën më pas e ka konfirmuar nga ARBK (DPKI-06-02/2169-1/2022), se zyrtari i lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme në biznese, duke bartur të drejtat e drejtimit të bizneseve tek një person tjetër (personi i besuar).

Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia konstatoi se zyrtari i lartë z. Gramos Agusholli, ka transferuar të drejtat e drejtimit të bizneseve private tek personi i besuar, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 15 të LPKI-së. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Bulleshikaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

